



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E
GJYQËSORE
SEKTORI I ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

Lënda: Në lidhje me trajtimin e kërkesës së z. Gezim Dafku për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në administratën publike.

Z. GËZIM DAFKU

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 13.06.2023, protokolluar me tonën nr. 3116, datë 13.06.2023, me anë të së cilës kërkon informacion në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuar në administratën publike, ju bëjmë me dije se:

Në zbatim të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pranimi në shërbim civil bazohet në parimet e parashikuara në nenin 20, të këtij ligji, ku përcaktohet se:

“1. Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

2. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit.”

Sipas procedurave që parashikon dhe garanton ligji i sipërcituar, pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur. Nëpërmjet këtyre standardeve synohet një pjesëmarrje sa më e gjerë dhe garantimi i transparencës maksimale nëpërmjet shpalljeve dhe njoftimeve përkatëse për të gjitha hapat e procesit. Nëpërmjet faqes zyrtare të DAP-it të gjithë të interesuarit për të konkurruar kanë akses në informacion dhe mund të aplikojnë për të marrë pjesë në procedurat e konkurrimit nëpërmjet kësaj platforme.

Theksojmë që Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse që udhëheq këtë proces garanton gjithpërfshirjen e çdo personi, pa përjashtuar personat me aftësi të kufizuara, në këto procedura, duke zbatuar parimet themelore të kuadrit ligjor që rregullon fushën e marrëdhënieve të punësimit në shërbimin civil.

Për sa më sipër, procedura është e njëjtë dhe nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për pranimin në shërbim civil të personave me aftësi të kufizuar të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të

posaçme të pozicionit të shpallur, në përputhje me nenet 21 e në vijim, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për më tepër, për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, ekzistojnë parashikime ligjore favorizuese, të cilat përcaktohen në:

1. Vendimin nr.243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, konkretisht pika 13, e Kreut IV.
2. Vendimin nr.242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, konkretisht pika 23, e Kreut II.
3. Vendimin nr.118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, konkretisht pika 18, e Kreut IV.

Referuar dispozitave të sipërcituara, kur në listën e renditjes së kandidatave fitues sipas pikëve, rezulton se ka kandidatë me pikë të barabarta atëherë kandidatët përzgjidhen sipas këtyre kriterëve:

“a) Në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër;

b) Në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë renditja bëhet duke renditur të parin kandidatin që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar për atë kategori në institucionin për të cilin konkurrohet. Gjinia më pak e përfaqësuar përcaktohet nga njësia përgjegjëse;

c) Në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e mësipërme, atëherë renditja e kandidatëve me pikë të barabarta bëhet nëpërmjet shortit.”

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se në procedurat e konkurrencës të zhvilluara nga Departamenti i Administratës Publike, në mënyrë të vazhdueshme, ka kandidatë që i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu dhe kandidatë që janë shpallur fitues e janë bërë pjesë e shërbimit civil, si në rastin e z. B. P., emëruar në përfundim të procedurës së konkurrencës së pranimit në shërbimin civil, në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Programeve dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme-Kategoria III b.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,